



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 3/802
Datë: 1/11/2018

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", me kërkesë të Parlamentit të Studentëve, në mbledhjen e mbajtur me datë 26.10.2018, mori:

V E N D I M

Për plotësim-ndryshim të paragrafit 2 të Vendimit të Senatit të UP-së nr. 3/145 të datës 31.10.2017 për afatet plotësuese të provimeve

Paragrafi 2 i Vendimit bazik të Senatit të UP-së nr. 3/145 të datës 31.10.2017 për afatet plotësuese të provimeve ndryshohet si në vijim:


1. Afati i nëntorit është afat plotësues. Në këtë afat studentët mund të paraqesin deri në dy provime. Provimet e dhëna në këtë afat nuk mund të llogariten për kusht.
2. Afati plotësues i nëntorit, me të drejtën e paraqitjes deri në dy provime, vlen vetëm për vitin akademik 2018/19.
3. Provimet do të mbahen gjatë ditëve të vikendit të muajit nëntor 2018.
4. Paragrafët tjerë të vendimit bazik nr. 3/145 të datës 31.10.2017 mbesin të pandryshuar.
5. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe vendimi i plotësuar/ndryshuar i Senatit, nr. 3/145 i datës 31.10.2017.

A r s y e t i m

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" e shqyrtoi kërkesën e Parlamentit të Studentëve për plotësim-ndryshimin e vendimit të senatit nr. 3/145 të datës 31.10.2017, përkatësisht për lejimin e afatit të nëntorit me të drejtën e paraqitjes deri në dy provime. Pas diskutimeve me argumente pro dhe kontra kërkesës, senatorët nga radhët e studentëve e arsyetuan kërkesën për lejim për faktin se aktualisht në Universitetin e Prishtinës ka numër të madh të studentëve, të cilët nuk kanë arritur që t'i përfundojnë provimet e viteve paraprake dhe po mbesin barrë e buxhetit të UP-së, gjithashtu disa nga njësitë akademike nuk po arrijnë që t'i vlerësojnë studentët në mënyrë permanente përmes kollokfiumeve, seminareve etj. Mbi bazën e argumentimit të kërkesës së Parlamentit të Studentëve, senati vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'u dorëzohet:

1. Menaxhmentit të UP-së,
2. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së,
3. Dekanëve të njësive akademike të UP-së,
4. Sekretarëve të njësive akademike,
5. Drejtorit të TI-së,
6. Zyrës ligjore të UP-së,
7. Arkivit të UP-së.



Prof. Dr. Marjan Dema

Kryesues i Senatit të UP-së